

Parku i Energjisë me Erë Bajgora

Shteti: KOSOVË

Projekti Nr.: 50423

Sektori i biznesit: Energji

Lloji i Njoftimi: PRIVAT

Kategoria Mjedisore: A

Data e Synuar e Bordit: 11 Dhjetor 2019

Statusi: Ka kaluar miratimin final; ne pritje te miratimit nga bordi

PSD e shpalosur ne gjuhen angleze: 14 Qershor 2019

Përshkrimi i projektit

Ofrimi i një kredie afatgjatë për të financuar ndërtimin e parkut të energjisë me erë 105MW që gjendet në Komunën e Mitrovicës në Kosovën Veriore ("Projekti"). Projekti do të zbatohet nga Sowi Kosova Sh.p.k., një sipërmarje për qëllime të posaçme e themeluar për qëllimin e projektit, në pronësi të Enlight Renewable Energy së bashku me partnerët kosovarë dhe gjermanë.

Objektivat e Projektit

Projekti do të kontribuojë në zbutjen e ndikimeve klimatike, duke rritur pjesën e gjenerimit të energjisë së ripërtërishme në Kosovë dhe duke shtuar 105 MW të kapacitetit të gjenerimit të energjisë me erë në sistemin kombëtar të energjisë. Projekti do ta rrisë ndjeshëm pjesën e energjisë elektrike të gjeneruar nga energjia e erës në Kosovë, që përndryshe është kryesisht e varur nga gjenerimi i energjisë me thëngjill.

Ndikimi i Tranzicionit

Projekti do të shtojë kapacitete të ripërtërishme prej 105 MW, duke mbështetur cilësinë e tranzicionit "të gjelbër". Kjo do të kontribuojë në reduktimin e emetimeve të CO2 në vend.

Informacioni i Klientit

Sowi Kosova SH.P.K.

Huamarrësi është një mjet për qëllime të veçanta i regjistruar në Kosovë me qëllim të zhvillimit, ndërtimit dhe operimit të projektit.

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

55,000,000.00 EURO

Gjithsej Kosto të Projektit

157,000,000.00 EURO

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategoria A (2014 PMS). Projekti përfshin zhvillimin e tre projekteve fqinje të energjisë me erë, me një kapacitet total prej 105MW, në një zonë malore pranë Mitrovicës, në Kosovën veriore. Energjia elektrike do të eksportohet përmes një linje transmetimi prej 19 km 110kV për në Vushtrri, që do të zhvillohet nga Projekti dhe pastaj do t'i bartet KOSTT-it, kompanisë shtetërore të transmetimit. Projekti është i kategorisë A, dhe kërkon një VNMS dhe shpallje publike prej 60 ditëve. Çështjet kyçe mjedisore dhe sociale që lidhen me projektet e energjisë së erës përfshijnë: humbjen e habitatit; rreziqet e përplasjes së shpendëve dhe lakuriqëve të natës; blerjen e tokës dhe ndikimet ndaj përdoruesve të tokës; si dhe ndikimet sociale, duke përfshirë ndikimet vizuale, hijen dhe zhurmën.

Projekti ka zhvilluar një paketë të dokumentacionit të VNMS-së, duke përfshirë VNM-të kombëtare, raportet e vlerave bazë që dokumentojnë biodiversitetin e ndryshëm, dhe anketime sociale. Ky dokumentacion është shqyrtuar nga një konsulent i huadhënësve dhe nga Banka, i cili ka identifikuar fusha të ndryshme ku kërkohen studime dhe vlerësime të mëtejshme për ta përafëruar plotësisht paketën e VNMS-së me kërkesat mjedisore dhe sociale të BERZH-it dhe ato të huadhënësve të tjerë të Projektit. Kjo punë shtesë është aktualisht në zhvillim e sipër dhe përfshin anketa të mëtejshme të shpendëve, lakuriqëve të natës dhe florës, pjesërisht të nxitura nga pjesa veriore e Projektit që shtrihet në një zonë të caktuar si Zonë e Rëndësishme për Zogjtë (ZRZ), ZRZ-ja e Kopaonikut, si dhe anketa të mëtejshme sociale dhe shqyrtimin e blerjes së tokës për Projektin dhe linjën e transmetimit.

Pas kompletimit të një paketë të përshtatshme të VNMS-së, ajo do të shpalojë për 60 ditë online dhe në zonën e Projektit. VNMS-ja do të përfshijë një Përmbledhje Joteknike dhe Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit, si dhe një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social për ta strukturuar Projektin në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale të huadhënësit.

Ky DPP do të përditësohet derisa të përfundohet vlerësimi i Bankës dhe të shpalojë VNMS-ja.

Bashkëpunimi Teknik

Nuk ka

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Emri i kontaktit: Marko Liposcak

Telefon: +972-3-9008700

Ueb faqe: www.enlightenergy.co.il

E-mail: marko@enlightenergy.co.il

Faks: +972-3-9008701

Adresa postare: 13 Ha'amal St., Afek Industrial Park, Rosh Ha'ayin, Israel 4809249

Mundësitë për biznes

Për mundësitë për biznes ose prokurimet, kontaktoni shoqërinë kliente.

Informacione të përgjithshme

Informacione rreth projekteve të BERZH-it që nuk lidhen me prokurimet:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika e Informimit Publik (PIP)

PIP-ja përcakton mënyrën se si BERZH-i e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe perceptimin më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të saj. Ju lutemi vizitoni faqen e mëposhtme të Politikës së Informimit Publik për të zbuluar se si të kërkonit Raportin e Bordit për Sektorin Publik.

[Teksti i PIP-së](#)

Mekanizmi i Ankimit të Projektit (MAP)

[Mekanizmi i Ankimit të Projektit](#) (MAP) është mekanizmi i llogaridhënies së BERZH-it. Ai mundëson shqyrtimin e pavarur të ankesave të individëve dhe organizatave lidhur me projektet e financuara nga BERZH-i, të cilat hamendësohet të kenë shkaktuar, apo të kenë gjasa të shkaktojnë, dëme mjedisore dhe sociale.

Ju lutemi vizitoni faqen e [Mekanizmit të Ankimit të Projektit](#) për më tepër informacion rreth mënyrës së depozitimit të një ankese. Përgjegjësi i MAP-it (pcm@ebrd.com) është në dispozicionin tuaj për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje që mund të keni lidhur me depozitimin e një ankese dhe kriteret për regjistrimin dhe përputhshmërinë, në pajtim me [rregullat e procedurës së MAP-it](#).